

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2019

SËMUNDJET DHE KOMPLIKIMET E GJIRIT

Edina Aliti

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Nursing Commons**



Koleji UBT
Fakulteti i Infermierisë

SËMUNDJET DHE KOMPLIKIMET E GJIRIT

Shkalla Bachelor

EDINA ALITI

Dhjetor, 2019
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Infermierisë

Punim Diplome
Viti akademik: 2016/2017

EDINA ALITI
SËMUNDJET DHE KOMPLIKIMET E GJIRIT

Mentori: PgD Shqipe Agushi

Dhjetor, 2019

ABSTRAKT

Hyrje:Gjinjet janë gjëndra mamare, simetrike, dhe çifte që hasen te të dy gjinit te meshkujt dhe vajzat e reja para pubertetit janë të pa zhvilluara dhe bëjnë pjesë ne organet riprodhuese. Si çdo organ i organizmit të njeriut edhe gjinjtë mund përfshihen nga sëmundje dhe procese patologjike. Qëllimi i punimit: është që të paraqesim të dhëna mbi sëmundjet e gjirit duke bërë rishikimin e literaturës. Të dhënat e përgjithshme:si çdo organ i organizmit të njeriut që mund ti nënshtrohet proceseve patologjike edhe gjinjtë nuk mund te përjashtohen. Sëmundjet e gjirit i ndajm në inflamatore, procese tumoroze (beninje, malinje). Këto procese shoqerohen me ndryshime subjektive siq janë dhembjet dhe ndryshimet objektive, ndryshimet në form gunge ose nyja në gji, pezmatim të pjesshem ose të plotë të gjirit, gjegjësisht rrjedhje e sekrecionit nga thithmi. Shumica e tumoreve të gjirit janë beninje kjo do të thotë se nuk përhapen ngelin, brenda një zone të lokalizuar dhe shpesh nuk kërkojnëkurrfarë trajtimi. Kanceri i Gjirit është përgjegjës për një të tretën të kancerve tek grate.Ka nivelin më të lartë të incidences krahasuar me të gjitha llojët tjera të kancerit cdo e shtata grua vuan nga kjo sëmundje gjatë jetës së saj. Ende nuk është kuptuar në tërsi se si shkaktohet kanceri i gjirit megjithate disa faktor të rrezikut janë identifikuar. .Metodat kryesore per diagnostifikimin e sëmundjeve të gjirit janë të mbështetura në të dhënat anamnestike, inspeksioni-veshtrimi dhe palpacioni-prekja sidomos vetkontrollimi, keto duhet te plotsohen me metodastandarte diagnostifikuse siq janë: mamografia, ultrasonografia-sonomamografia si dhe rezultatet e analizave citologjike te materialit te fituar me rastin e punkisonit dhe sekrecionit qe rrjedh nga gjiri.Antar kryesor të ketij ekipi duhet të perfshije: nje konsulant histopatolog, nje konsulant citolog,konsulant radiolog, konsulant kirurg,konsulant onkologmjeksor,konsulant onkolog klinik,dhe infermierja per kujdesin e gjinjeve. Antaret tjere perfshijne: nje kirurg plastik, radiografist, koordinator i ekzaminimve dhe rezultatve, psikolog klinik, specialist I gjenetikes, dhe stafi administrativ.Mjekimi i sëmundjeve të gjirit varet nga lloji i sëmundjes dhe mbështetet në trajtimin kirurgjik, kemoterapi, terapia hormonale, dhe terapia jonizuse. Përfundim: Sëmundjet e gjirit munden me qenë me natyrë inflamatore dhe procese tumoroze.

Proceset tumoroze munden me qenë me natyrë beninje ose malinje. Të gjitha simundjet e gjirit janë të sherueshme duke përfshirë edhe kancerin e gjirit, nëse ai zbulohet me kohë.

Fjalët kyçe: Sëmundjet e gjirit,diagnostifikimi, klasifikimi, mjekimi.

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Falënderim të posaçëm i shpreh udhëheqësit të këtij punimit: Prof. Shqipe AGUSHI, profesore e kolegjit, e cila me korektësi maksimale, në çdo kohe ka qenë e gatshëm për të më dhënë këshilla, sugjerime dhe mendime për realizimin dhe përfundimin e këtij punimi.

U jam mirënjohëse të gjithë atyre që në çfarë do mënyre kontribuan në kryerjen dhe përfundimin e këtij punimi e sidomos: Profesorëve, Asistentëve, stafit udhëheqës dhe të gjithë personelit të kolegjit UBT të cilët gjithmonë dhe në çdo kohe kanë qenë të gatshëm për të më ofruar këshilla dhe motive studimi me përkrahjen e tyre të pakursyer shkencore morale e profesionale.

Në fund por jo edhe në vendin e fundit falënderoj familjen time dhe i shpreh mirënjohjen e thellë të cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi, sa të vështirë aq edhe të bukur, për mirëkuptim, durim, mbështetjen dhe përkrahjen që me kanë ofruar, për çka për jetë u jam falënderues dhe mirënjohëse.

PËRMBAJTJA

Lista e figurave	VIII
Lista e tabelave	VIII
FJALORI I TERMAVE	IX
1.HYRJA	1
1. SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
2.1 Anatomia dhe fiziologjia e gjirit.....	4
1.2 Anamneza familjare	5
2.3 Ekzaminimi klinik	5
2.3.1.Palpacioni	5
2.3.2 Investigimet	6
2.3.3 Mamografia	6
2.3.4 Rezonanca magnetike	7
2.3.5 Citologjia aspirative me gjilpër të hollë	7
2.3.6 Core biopsy.....	8
2.4 Klasifikimi i sëmundjeve të gjirit	8
2.4.1 Sëmundjet beninje të gjirit.....	8
2.4.2 Sëmundjet fibrocistike.....	9
2.4.3 Rrjedhja nga thithmi	9
2.4.4 Inflammacioni i gjirit.....	9
2.4.5. Fibroadenomat	10
2.4.6 Tumori filodes	10
2.4.7 Hamartomet	10
2.4.8 Cistet.....	11
2.4.9 Tumoret granulare qelizor	11
2.4.10 Dermatiti kronik i thithmit të gjirit.....	12
2.4.11 Sëmundja e Paxhet-it.....	12
2.5 Kanceri i gjirit.....	12
2.5.1 Epidemiologjia e kancerit të gjirit	13
2.5.2 Anamneza familjare.....	13
2.5.3 Gjina	14
2.5.4 . Aktiviteti fizik	14
2.5.5 Alkooli	14

2.5.6 .Vetëkontrollimi i gjinjeve.....	15
2.5.7. Mjekimi	17
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	19
3.1 Qëllimi i problemit	19
3.2 Hipotezat e punimit	20
4. METODOLOGJIA.....	21
4. REZULTATET	22
6.DISKUTIM DHE KONKLuzion	32
7.REFERENCAT	35
8. SHTOJCAT	38

Lista e figurave

Grafika 1 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore .	23
Grafika 2. Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore	24
Grafika 3 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore	25
Grafika 4 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore .	26
Grafika 5 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore .	27
Grafika 6 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore	28
Grafika 7 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore .	29
Grafika 8 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore .	30
Grafika 9 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore .	31
Grafika 10 Shpërndarja në përqindje e pjesëmarrësve në studim sipas gjinisë femërore	32

Lista e tabelave

Tabela 1Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	22
Tabela 2Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	23
Tabela 3 Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	24
Tabela 4Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	25
Tabela 5Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	26
Tabela 6 Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	27
Tabela 7 Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	28
Tabela 8 Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	29
Tabela 9 Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	30
Tabela 10 Mënyra e përgjigjeve në bazë të %	31

FJALORI I TERMAVE

FSH- hormonin stimulus folikular

LH- hormonin luteinik

THELITIS- inflamacion i thithmit

AREOLES- inflamacioni i areoles

INTERRIGO- ekcem i sulkusit submamar

AMASTIA- mungesa e gjirit

MICROMASTIA- gjinjet e vegjël

MACROMASTIA- gjinje te mëdhej

1.HYRJA

Shumica e tumorve në gjinj janë beninj, kjo do të thotë se ato ngelin brenda një zone të lokalizuar nuk përhapen dhe nuk kërkojnë shpesh kurrfar trajtimi mëqë nuk shkaktojnë dëme. Në këtë grup të sëmundjeve bëjnë pjesë: proceset inflamatore, tumorët beninjë të gjirit. Në grupin e sëmundjeve beninjë të gjirit bëjnë pjesë: çrregullimet e zhvillimit, të njohura si: mungesa e gjirit (amastia), gjinjet e vegjël (micromastia), gjinje të mëdhej (macromastia), numer i tepërt i gjinjëve (polymastia), mungesë e thithmit (athelia), thithmi i imët (microthelia), numer i tepërt i thithmave (polythelia). Çrregullimet e funksionit, të njohura si: galaktorea, gjiri që kullon, gjiringa i cili rrjedh gjak, mastodinia-gjiri me dhembje, gjidhënia e zgjatur, rrjedhja spontane e qumështit. Më së paku që një grua-femer që mund të bejë për veten është që ti vetë kontrollojë gjinjet e saj njëherë në muaj. Vetkontrollimi gjinjëve është metoda e parë dhe më e përhapur për zbulimin e hershëm të ndryshimeve në gjë. Kjo metodë për shkak të menyrës së thjeshtë të realizimit dhe pa pasur nevojë për shpenzime, paraqet metodën themelore, në vargun e ekzaminimeve për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Kanceri i gjirit është i pranishëm 2-8 vjet para se mund të hetohet apo të diagnostifikohet. Cdo femer, me vetkontrollimin e gjinjëve duhet të fillojë që në moshën 20 vjeçare, por jo më vonë se 25 vjece. Kuptimi i vetkontrollimit të gjinjëve është se gruaja të mëson ose të kupton ndertimin normal të gjinjëve të saj, duke njohur formën, madhësinë, ndertimikositencën normale të gjinjëve. Vetkontrollimi duhet të kryhet një herë në muaj përafërsisht cdo muaj në të njëjtën kohë. Gjinjet janë organe dyshe simetrike që janë të vendosura në të dy anët e përparme të krahërorit si dy të ngritura në formën e disqeve konike. Ato janë të stabilizuara me një ligament mbajtës të njohur si ligamenti i Cooper-it. Struktura mamare është e përberur nga 15-20 lobe glandulare që në vetvete ndahen në lobule me të vegjël në numër sa dyfishi. Në pjesën qendrore të secilit gjë gjenden thithmi-areola i cili është i pasur me fibra muskulare të lemuar, të cilët janë përgjegjës për ereksionin ngritjen e thithmave. Areola është zonë e rrumbullakët e pigmentuar me madhësi 2.5 cm në diametër.

2.SHQYRTIMI I LITERATURËS

Gjëndrat mamare tek femrat fillojnë të ndryshojnë në periudhën e pubertetit. Gjendra pirutare fillon të prodhojë hormone gonadotropinën, hormonin stimulus folikular (FSH), dhe hormonin luteinik (LH). Me rritjen e niveleve të hormoneve folikulet që gjenden në koren e vezorve fillojnë të prodhojnë estrogenin i cili është përgjegjës për fazat e para të zhvillimit të gjinjeve. Estrogenet po ashtu indukojnë indin lidhës dhe rritjen vaskulare që i nevojitet për ta mbështetur sistemin dukтал. Me të filluar ciklin e ovulacionit, prodhimi i rritur i progesteronit e balancon prodhimin e estrogenit, gjë që rezulton në maturimin e indit glandular.

Gjinjet janë organe dyshe simetrike që janë të vendosura në të dy anët e përparme të krahorit si dy të ngritura në formën e disqeve konike. Ato janë të stabilizuara me një ligament mbajtës të njohur si ligamenti i Cooper-it. Struktura mamare është e përberur nga 15-20 lobe glandulare që në vetvete ndahen në lobule me të vegjël në numër sa dyfishi. Në pjesën qendrore të secilit gjë gjendet thithmi-areola i cili është i pasur me fibra muskulare të lemuar, të cilët janë përgjegjës për ereksionin ngritjen e thithmave. Areola është zonë e rrumbullakët e pigmentuar me madhësi 2.5 cm në diametër. Ngjyra është rozë tek gratë e racës së bardhë ndërsa tek gratë me lëkurë të zezë e kanë ngjyrë kafe në të mbyllt, gjatë shtatzanis kjo bëhet më e errët përth areoles. Në sipërfaqe gjendet një numër i caktuar të njohura si nyja turberkulet të Montgomerit të cilat janë gjendra të modifikuar adhamore qëllimi i të cilave është të lubrifikojnë thithmin gjatë laktacionit. Gjiri përbehet nga indi dhjamor, gjëndrore, lidhor si dhe është i mbuluar nga lëkura. Indi dhjamor është i vendosur në mes të lëkures dhe facies superficiale është i shpërndarë në sasi dhe pjesë të ndryshme të gjirit, sasia e indit dhjamor varet prej moshës, gjendjes së përgjithshme shëndetësore, majmëris, periudhës së shtatzanis, periudhës së laktacionit. Indi gjëndror njësia themelore është acinusi, disa acinuse kur bashkohen përbejnë një strukturë në formë të kalaveshit që quhen lobule të cilat kur bashkohen përbejnë njësien themelore të gjendres së qumshtit i cili përfshin edhe duktusin alveolar në të gjendet një numër i caktuar të njohura si nyja turberkulet cilin derdht përmbajtja e lobulit. Indi lidhorndertohet nga ligamentet e Cooper-it të cilët shtrihen nga lëkura deri në fascien pektorale e cila është e vendosur poshtë tyre.

Gjiri furnizohet me gjak nga arteriet e gjirit të cilat dalin nga tri burime: arteria thoracica,interna, arteria thoracica lateralis, dhe arteriet intercostales, perkatsisht pleksusi subdermal, preglandular, dhe retroglandular.Rol të rëndsishe ka edhe drenazhi limfatik e cila behët përmes enve të gjakut kah venat interne, mamare,aksilare.

Furnizimi nervor behët përmes nervave sensore, somatike, dhe nervave autononike që i shoqërojnë enët e gjakut. Kompleksi thithmi-areola furnizohet nga nervat sensore somatike,ndërsa pjesa tjetër furnizohet nga furnizimi autonomik. Limfa derdhët në enët limfatike aksilare, subklavikulare, mediastinale dhe në drejtim të një pjese të mëlqis dhe nyjet limfatike subdiafragmale. Në cdo nënsqetull ka rreth 20-30 nyja limfatike që drenojn limfën nga gjinjet. Nyjat limfatike ndahen në tre nivele:


Niveli I: është i vendosur në menyr laterale të muskujt e vegëjl pektoral.

Niveli II: ndodhet nën muskujt e vegëjl pektorale.

Niveli III: është i vendosur në menyr mediale te muskujt e vegjel pektoral. Ndryshimet që ndodhin në gjinje shpesh janë simptomi i parë i shtatzanis.Gruaja ankohet për fryrje, zbutje apo rritje e madhsisë. Venat bëhen me të spikatura-theksuara për shkak të furnizimit të rritur me gjak dhe areola dhe thithmi marrin ngjyrë të errët.Këto ndryshime ndodhin në rradh parë për shkak të estrogenit dhe progesteronit e më pas edhe në hormonet e prodhuara në placent. Estrogjeni stimulon kompleksin thithm-areol duke shkaktuar errësim të ngjyrës ndërsa progesteroni shkakton proliferimin e alveoles në përgaditjen e qumshtit. ¹Placenta duke u rritur sekretion laktogjenin placentar human i cili funksionon krahas estrogenit dhe progesteronit për ta stimuluar hipotalamusit për të sekretuar hormonin prolaktin-nxitës. Pas lindjes dhe largimit të placentes, shfaqet fluktacioni në nivelet e estrogenit dhe progesteronit duke rezultuar me leshimin e prolaktines nga gjendra piturtare anteriore. Estrogjeni bllokon veprimin e prolaktines, prandaj qumshti vjen jo me parë se para 3 ditvë. Në ndërkoh foshnja ushqehet me kulloshtren (colostrum) që përmban pak yndyr dhe përmban vitamin A proteina dhe minerale.

2.1 Anatomia dhe fiziologjia e gjirit

Gjinjet janë organe ndihmëse rëndom simetrike dhe çifte të aparatit gjenital femëror. Gjinjet bëjnë pjesë në organet riprodhuese, ato kanë funksion të rëndësishëm për sigurimin e qumshetit për foshnjën. Peshë mesatare e një gjiri të zhvilluar normalisht, në periudhën riprodhuese është 200- 300 gram. Gjinjet fillojnë të zhvillohen rreth javës 7-të të shtatzënis dhe kalojnë në fazën e gufimit rreth javës së 12-të. Gjëndrat e qumshetit zhvillohen nga rudhat ektodermale që formohen në sipërfaqen ventrale të embrionit. Testosteroni ndikon në rritjen dhe zhvillimin pas javës 15-të. Në disa raste gjatë lindjes, nga gjiri i foshnjës mund të dalë një sasi e vogël e qumshetit. Kjo ndodh për shkak të niveleve të larta të hormoneve luteale dhe placentale që kalojnë nëpër placentë dhe futen në qarkullimin fetal, gjatë fazës së vonshme të shtatzënis. Gjatë zhvillimit embrional, rreth mesit të shtatzënisë dy sythat mamare, që janë paracaktuar për të formuar gjinjët, fillojnë të rriten dhe të ndahen. Formohen 15-25 sytha që janë sistem i kanalit qumështor të gjirit tek të rriturat. I tërë regjioni i areoles së gjirit dhe i thithmit të gjirit është i pigmentuar në mënyrë intenzive ky pigmentim shtohet më shumë gjatë periudhës së shtatzënisë. Futja-tërheqja e thithmit të gjirit brenda mund të jetë dukuri e lindur por edhe e fituar.²



Ndërtimi anatomik i gjirit (sipas: F.H. Netter, Ciba Collection, Clinical Symposia)

Fig: 1 Ndërtimi anatomik i gjirit

Burimi: Sëmundjet e gjirit, Selami Sylejmani MD, PhD

² (sylejmani, 2016)

1.2 Anamneza familjare

Të dhënat anamnestike duhen të shikohen në kuadër të vleshmëris së simptomave. Kjo ndihmon në përcaktimin e diagnozës dhe identifikimin e faktorve të riskut.

Të dhënat që duhet të sigurohen janë:

- Moshë e pacientit
- Sëmundjet në të kaluarën
- Praninë e sëmundjeve malinje në familje
- Moshën e paraqitjes së menarkes dhe menopauzes
- Numrin e lindjeve
- Numrin e shtatëzanive
- Numrin e dështimve
- Përdorimi i terapisë zëvendësuese hormonale
- Nëse pacientja u ka dhënë gji foshnjve të saj
- Menstruacionet e fundit

2.3 Ekzaminimi klinik

Është shumë me rëndësi që të sigurohet një ambient sa më komod dhe i këndshëm për pacientin. Të sigurohet një veshje e përshtatshme, perdet rreth shtratit, dyert duhet të jenë të mbyllura për të siguruar privatsin për gruan. Një përcjells duhet të jetë prezent, vërshtë nga politikat individuale tëspitalit.

Ekzaminimi klinik ndahet në dy pjesë:

1. Palpacioni
2. Inspeksioni

2.3.1.Palpacioni

Palpimi ose prekje e ndryshimve në gjinj ka rëndësi të veçantë në zbulimin e hershëm të sëmundjeve të gjirit. Në shumicën e rasteve të kancerit të gjirit pacientet janë vet ato që i hetojnë ndryshimet në gjinj. Krahas vetkontrollimit të rregullt të gjirit rekomandohet edhe ekzaminimi specialistik. Gjatë kësaj vizite duhet të palpohen në mënyrë sistematike

gjinjet, edhe gjatë qëndrimit në këmb, ulur, në pozitën shtrirë. Koha më e përshtatshme për kontrollin e gjinjve është peiudha pas përfundimit të ciklit menstrual deri në mes të ciklit.³ Ndryshimet që preken eventalisht duhet të krahason me madhsit si;

- Madhsia sa kokrra e bizeles që ka madhsinë rreth 1cm
- Madhsia sa kokrra e kikirikut me madhsi 2cm
- Madhsia sa kokrra e arres qe I përgjigjet madhsis rreth 4cm
- Madhsia sa një kokerr limon që ka madhsinë 5cm

Qëllimi i gjithë vizitave dhe ekzaminimeve të gjinjve është zbulimi sa më i hershëm i kancerit të gjirit. Gjatë inspeksionit veshtrohët dukja e gjinjve në tërsi, dallimet në madhsi dhe në form, simetria, si dhe deformimet eventuale. Veshtrohen edhe thithmi, forma, pozita, ndryshimet në lëkuren e thithmit. Kujdes të veçant duhet kushtuar ndryshimevesi: tërheqja elëkures së gjinjve, ndryshimet në formë, te levoërs së portokallit, ndryshimi i ngjyrës së lëkures, edema e lëkures, ulqerime ose plagza në lëkuren e gjinjve, të ngritura në form nyjesh e ndryshime tjera të pa rëndomta, të cilat mund ti kenë renë ne sy vet pacientes. Gjatë egzaminimit pacientja duhet të qëndroj ulur në gjendje tërehatshme.

2.3.2 Investigimet

Numër i madh i grave nuk i kontrollojnë gjinjtë e vet nga frika se mund të gjejnë ndonjë ndryshim, i cili mund të jetë kancer i gjirit. Me injorimin e kontrollit dhe vetëkontrollit të gjinjve, ndryshimet eventuale në gji asnjëherë nuk do të eliminohen vetvetiu, përkundrazi, ato vetëm sa do të shtohen. Krahas vetëkontrollit të rregullt të gjirit, rekomandohet edhe ekzaminimi specialistik i kohëpaskohshëm i gjirit. Qëllimi i të gjitha vizitave dhe ekzaminimeve të gjinjve është zbulimi sa më i hershëm i kancerit të gjirit mundësisht në fazën fillestare kur edhe mjekimi është i suksesshëm për të thënë edhe 100 për qind. Në vazhdim do të përmendim disa nga mënyrat dhe metodat kryesore për diagnostikimin e sëmundjeve të gjinjve.

2.3.3 Mamografia

³ (Radiology, 2003)

Është metoda e parë dhe më e pranushme diagnostifikuse për zbulimin e hershm të sëmundjeve të gjirit. Mamografia është metodë imazherike që bënë inqizimin e gjinjeve me rreze X të dozës së ulët. Mamogramet nuk preferohen të behën para moshës 35 vjeqare.

3.2 Ultratingulli-sonomamografia. Ekzaminimi me ultratingull është i padëmshëm pavarësisht sa here peseritet dhe së bashku me mamografin rritësaktësin diagnostifikuse të sëmundjeve të gjirit qofshin ato malinjeapobeninje. Vizita ultrasonogafike është shumë e vleshme, sidomos për dallimin e tumorve solide, me ata cistik si dhe për shqarimin e shumë strukturave që prekën me dorë gjatë vetkontrollimit të gjinjeve, dhe është i dobishëm sidomos të gratë para moshes 35 vjeq.⁴

2.3.4 Rezonanca magnetike

Rezonanca magnetike përdor fushë të fuqishme magnetike dhe sinjale me valë radioje që reflektohet nga gjiri. Këto sinjale maten dhe transmetohen në kompjuter, duke dhënë pamjënë gjirit. Gjatë kësaj vizite pacientje duhe të jetë e shtrirë në tavolinen speciale e shtrirë në bark, përdorimi i MRI është i kufizuar për disa arsye: ajo gjithëmon bën dallime në mes tëprocesve beninje dhe malinje, kërkon kohë dh nuk lokalizon mikrokalcifikimet që flasin për kancer të kanalve të qumshtit, gjatë MRI pacienja duhet të qëndroj shtrirë dhe pa lëvizur në një vend të ngushtë qendrim i pa përshtatshëm për pacientet që vuajn nga frika e qëndrimit në vend të ngushtë-klaustrofobia.

2.3.5 Citologjia aspirative me gjilpër të hollë

Citologjia aspirative me gjilper të hollë (FNAC-Fine-needle aspiration cytology) mund të performohet me dorë të lirë nga ana e klinikistit me apo pa udhëheqjen me ultratingull. Rëndom përdoret me një shiring 10 ml me gjilpër 21G ose 23G. Lëkura pastrohët dhe gjilpera insertohët në gung. Materilai I mbledhur shpërndahët në shtresë të hollë në një pllakzë dhe lihet të thahët në ajrë. Pastaj pllakzat interpretohet nga ana e citologut, rezultatet caktohen sipas sistemit numerik:

- C1 jo adekuat

⁴ (Asoglu O, 2005)

- C2 beninj
- C3 I papërcaktuar me gjasë beninj
- C4 I papërcaktuar me gjasë malinj
- C5 malinj.

2.3.6 Core biopsy

Nëse rezultatet e FNAC nuk janë konkluzive, ose kërkohet histologjia duhet të kryhet core biopsy. Core biopsy kryhet me dorë të lirë ose nën udhëheqjen imazherike. Anestetiku lokal injektohet në gji, behët një prerje e vogël me skalpel dhe një gjilpër e biopsis futet derisa maja ta prek gungën. Shkrepet revolja e biopsis e cila merr material nga thelbi i indit. Ky material pastaj dergonet në histopatologji. Kujdes të veçantë duhet kushtuar pacientve që marrin warfarin, meqë ato së pari duhet të marrin IRN-në e tyre. Biopsit e thelbit janë klasifikuar njejtë sikurse rezultatet citologjike me shkronjen B si prefiks si për shembull B1, B2.⁵

2.4 Klasifikimi i sëmundjeve të gjirit

Si çdo organ i organizmit që u nënshtrohet procesve patologjike edhe gjinjet nuk mund të përjashtohen. Sëmundjet e gjirit i ndajm; inflamatore, procese tumorozë (beninje, malinje). Këto procese shoqerohen me ndryshime subjektive siq janë dhembjet dhe ndryshimet objektive, ndryshimet në formë gunge ose nyja në gji, pezmatim të pjesshem ose të plotë të gjirit, gjegjësisht rrjedhje e sekrecionit nga thithmi.

2.4.1 Sëmundjet beninje të gjirit

Shumica e tumorve në gjinj janë beninj, kjo do të thotë se ato ngelin brenda një zone të lokalizuar nuk përhapen dhe nuk kërkojnë shpesh kurrfarë trajtimi mëqë nuk shkaktojnë dëme. Në këtë grup të sëmundjeve bëjnë pjesë: proceset inflamatore, tumorët beninje të gjirit. Në grupin e sëmundjeve beninje të gjirit bëjnë pjesë: crregullimet e zhvillimit, të njohura si: mungesa e gjirit (amastia), gjinjet e vegjël (micromastia), gjinje të mëdhej

⁵ (welfare, 2006)

(macromastia), numer i tepërt I gjinjëve (polymastia), mungesë e thithmit (athelia), thithmi i imët (microthelia), numer i tepërt I thithmave (polythelia). Çrregullimet e funksionit, të njohura si: galaktorea, gjiri që kullon, gjiringa i cili rrjedh gjak, mastodinia-gjiri me dhembje, gjidhënia e zgjatur, rrjedhja spontane e qumështit. Ndryshimet regresive në gjinj, të njohura si: atrofi e gjinjëve, distrofi, krijimi i kalcifikatve dhe statonekroza, që shfaqet në form gunge kalcike e shoqëruar me dhembje. Ndryshimet inflamatore në gjinj, të njohura si: inflamacion i thithmit (thelitis), inflamacioni i areoles (areolitis), ekcem i sulkusit submamar (intertrigo), inflamacion i gjendres së qumështit (mastitis), proces inflamator i kufizuar, i përcjell me vatra qelbi (abscessus), infeksion me qelb i lëkures dhe i nënlekures së gjirit (carbunculus), dhe më rrallë tuberkuloza, sifilisi, dhe aktinomikoza e gjirit. Displazit e gjinjëve: sëmundjet fibrocistikee gjirit, e shpeshtë dhe më e rendsishme.⁶

2.4.2 Sëmundjet fibrocistike

Sëmundja fibrocistike është një ndryshim beninje në gjinjë, zakonisht i dyanshem, e cila përshkruhet si struktur granulare e gjirit. Sëmundja fibrocistike shfaqet gjatë tërë periudhës riprodhuese të gruas dhe para se gjithash, atakon pjesët e sipërme laterale të gjinjëve. Disbalansimi në mes të estrogenit dhe progesteronit krijojnë ndryshime të shumta në indin e gjirit, të cilat i emertojnë bashkarisht si sëmundje fibrocistike.⁷

2.4.3 Rrjedhja nga thithmi

Me këtë gjendje nënkuptohet shfaqja e sekrecionit nga thithmi jashtë periudhës së shtatzanis, apo dhdhënies gjë. Sekrecioni i gjirit mund të jetë i ndryshëm, si për nga ngjyra ashtu edhe nga cilësia. Sekrecioni i gjirit me ngjyrë të verdhë, të tejdukshme, të bardhë apo të gjelbër, nuk është shenjë e ndonjë gjendje brengosese në gjë. Sekrecioni i cili sipas së cilit kërkon trajtim dhe analizë, është ai i cili përmban më pak apo më shumë gjak.

2.4.4 Inflamacioni i gjirit

⁶ (Adeniran, 2004)

⁷ (Adzersen KH Eustachi A, 1999)

Proceset inflamatorë mund të kaplojnë indin e gjirit (mastitis) ose vetëm thithmin (thelithis). Shkaktar më të shpeshtë janë bakteret gram pozitive, si streptokoket dhe stafilokoket që karakterizohen me shenja karakteristike për procese inflamatorë. Inflamacioni i gjirit jashtë periudhës së dhënies gjë është dukuri më e rrallë. Edhe nëse paraqitet, zakonisht është i kufizuar në një pjesë më të vogël të gjirit, kryesisht në pjesën përth areoles.⁸

2.4.5. Fibroadenomat

Janë tumore me të shpeshta beninje të gjirit, tek grat nën moshën 30 vjeqe. Në shumicën e rasteve, janë tumor relativisht të vegjël, rreth 2-3 cm me diametër, ndonjë mund të jenë ndonjëherë të mëdhenj, bile edhe gjigant, me madhësi 6-7 cm. Fibroadenomat janë më së shpeshti të rrumbullakët, të fort, të kufizuar mirë por nuk janë tumor të enkapsuluar zmadhohen në masë të vogël para përfundimit të ciklit menstrual, kur mund të shkaktojnë dhembje, spontanisht apo gjatë pekjës. Fibroadenomat rrallë kalojnë në proces malinj.⁹

2.4.6 Tumori filodes

Ky tumor paraqet variantin malinj të fibroadenomes. Tumori i filodes përmban në vetë qeliza

beninje epiteliiale, por indi që lidhë është malinj. Shfaqet rëndom tek grat në moshën 40-50 vjeqe. Sjellja e tumorit filodes shpesh është i paparishikueshëm. Shumica e këtyre tumorve paraqesin probleme lokale dhe nuk metastazojnë. Vetëm 20% të këtyre tumorve metastazojnë, dhe kjo ndodhë nëpërmjet sistemit të qarkullimit të gjakut, ejo me rrugë limfatike.

2.4.7 Hamartomet

Hamartomet janë tumore beninje të gjirit, që janë shpesh asimptomatike. Zbulohen rastesisht

⁸ (welfare, 2006)

⁹ (Frozen, 1993)

gjatë ekzaminimit ultrasonografik apo mamografik. Ky tip i tumorit më së shpeshti shfaqet pas moshës 35 vjeq. Mund të jenë plotësisht apo pjesërisht të inkapsuluar. Ndonjëher mund të paraqesin probleme në diferencim nga tumoret tjera beninje dhe nga ata malinje ndaj kjo është arsyeja që trajtimi i tyre të kryhet vetëm në menyr kirurgjike.

2.4.8 Cistet

Paraqesin ndryshimet më të shpeshta që hasen tek gratë ndërmjet moshës 40 dhe 50 vjeqare.

Cistet janë hapsira të mbushua me lëng që krijohen nga kanalet e zgjeruara dhe të mbyllura të

qumshtit. Mund të jenë si të vequara, apo disa sosh njëkosisht në njerin gji, por shpesh edhe në të dy gjinjet. Madhsia e tyre është e ndryshme nga ajo mikroskopike, kur nuk mund te hetohet me prekje, deri në madhsin prej disa centimetrash. Cistet e vogla nuk percillen me shqetsime të medha, po ato mund të rriten dhe të shkaktojn dhembje para fillimit të ciklit menstrual. Në rast se cistete vogla nuk shkaktojn shqetsime të veqanta, përcjellja bëhet me kontrole të rregullta specialistike, me ekzaminime të kohëpaskohshme ultrasonografike gjersa kistet e mëdha dhe ato që shkaktojn dhembje, mund te ju bëhet punctioni dhe mund te operohen.

.

2.4.9 Tumoret granulare qelizor

Në fillim të shekullit XX është menduar se këta tumore beninje kanë perardhjen nga indi muskolor, por fal mikroskopit elektronik, është vërtetuar se perardhja e tyre është nga qelizat që i ndërtojn mbështjellsit e fijeve periferike nervore. Periudha e shfaqjes është rreth moshës 40- vjeqare të gruas. Karakteristik e këtyre tumorve është se imponohen si tumore malinje të gjinjeve sepse kan forsi të theksuar gjatë kontrollit me dore dhe e fiksojn lëkuren.¹⁰

¹⁰ (Radiology, 2003)

2.4.10 Dermatiti kronik i thithmit të gjirit

Inflamacioni i lëkurës së thithmit, shfaqet në formë të një sipërfaqeje të skuqur në vetë thithmin, të mbuluar rëndom me shtresa të kreatinizuara të lëkurës së vdekur, përcjell shpesh edhe me kruarje. Kjo gjendje beninje është e vështirë ndonjëher të dallohet nga sëmundja e Paxhetit.

2.4.11 Sëmundja e Paxhet-it

Është një formë e rrallë e kancerit të gjirit. Kjo gjendje manifestohet si një sipërfaqe më pak a më shumë e kuqe, në formë të njollës në vetë thithmin, që mund të shtrihet edhe në rrethinën e vet në areol, dhe jashtë saj. Ndryshimi ka pamje të ekcemit, ndonjëher me zbokth të lëkures, e ndonjëher duket si plagzë sipërfaqësore në thimth. Të kuarit është dukuri e shpesht por nuk ka simptoma të domosdoshme. Gati gjysma e grave me ndryshime në thimth, kanë tumore gjiri të hetushm me prekje ndërsa 90% të tyre kanë tumore malinje të vendosur më thellë në kanalthet e qumshtit. Duhet të bëhet biopsia e këtij ndryshimi, dhe nëse deshmohet malinjiteti, trajtimi bëhet si për qafardo kanceri tjetër të gjirit të lokalizuar në pjesën qendrore të tij.¹¹

2.5 Kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit është një patologji malinje mjaft e shpesht tek grat dhe është më e rrallë tek burrat. Kanceri i gjirit zhvillohet nga qelizat e vet gjirit, kur qelizat fillojnë të rriten dhe të bëjnë anormale dhe përhapen në mënyrë masive. Këto qeliza grumbullohen dhe formojnë një tumor i cili shfaqet, përhapet dhe shkatërron indin normal gjirit. Nëse nuk trajtohen këto qeliza anormale mund të përhapen dhe të demtojnë, apo të shkatërronin indet normale që gjenden përreth. Ato mund të shpërthejnë dhe të shpërndahen ndonjëher përmes gjakut apo sistemit limfatik në pjesë të tjera të trupit. Shumica e kancerëve të gjirit fillojnë në qelizat përgjatë kanalve disa fillojnë në lobuluse dhe pjesa tjetër në indet tjera të gjirit. Tipet kryesore të kancerit janë: Carcinoma insitu: ky term përdoret në fazat e hershme të kancerit,

¹¹ (Radiology, 2003)

ku ai është i lokalizuar në vendin ku është shfaqur. Kjo do të thotë se kanceri është i lokalizuar në kanale ose lobule, varësisht se ku është shfaqur.¹²

Carcinoma ductale in situ; ky është tipi më i shpesht i kancerit joinvaziv i gjirit. Carcinoma ductale in situ do të thotë se kanceri është i kufizuar në duktuse-kanalet e qumshtit. Carcinoma lobulare in situ; kjo gjendje fillon e paraqitet në gjendrat që tajitin qumsht por nuk i deporton muret e lobulusve. Carcinoma ductale invasivum; është forma më e shpesht e kancerit të gjirit. Fillon në kanalet e qumshtit, deperton nëper muret e kanalit përfshin edhe parenkimen gjirit. Prej aty mund të përhapet në pjesë të tjera të trupit. Paraqet rreth 80% tekancerve invazive të gjirit. Carcinoma lobulare invasivum: kjo form e kancerit shfaqet në lobule apo gjendrat qumshtore. Mund te shpërndahet në pjesë te tjera të trupit. Në 10% te kancerve invazive të gjirit janë të ketij tipi.

Shenjat dhe simptomat më të shpeshta të kancerit të gjirit janë:

Forcim, erozion i lëkures, skuqje e lëkures, rrjedhje nga thithmi, gropza, rrudhosje e lëkures,

theksim i venave, invertim i thithmit, asimetria e gjinjëve, levorja e portokallit, gung e padukshme.¹³

2.5.1 Epidemiologjia e kancerit të gjirit

Numri më të madh të prekurave nga kjo sëmundje shenohet në vendet e zhvilluara perndimore ndersa numrin më të vogel e shenojn vendet e Lindjes së larget. Kanceri I gjirit ka filluar të marr përmasa të mëdha epidemike. Nga kjo sëmundje malinje vdesin në botë rreth 400.000 gra, në bote ndersa smuren reth 1.000.000 cdo vite. Megjithat shkallae vdekshmeris nga kanceri i gjirit është në rënie. Kjo rënie është me gjasë rezultat i zbulimit të hershëm të kancerit dhe trajtimit mjeksor më të avancuar.

2.5.2 Anamneza familjare

¹² (Radiology, 2003)

¹³ (Adeniran, 2004)

Afërsisht 5-10% të rastve me kancer gjiri kanë në bazë trashëgimin. Ndryshimet në gjene apo

demtimi i tyre mund të trashëgohët dhe mund ta trashëgoj kancerin. Rreziku relativ i shfaqjes së kancerit të gjirit është më e lartë tek grat që kanë të afërm gjaku me këtë sëmundje. Nëse gruaja e ka nënën, motren, apo vajzen me kancer të gjirit, kjo e dyfishon rrezikun për të.

Gjasat që një grua të ketë kancer të gjirit rriten me kalimin e moshës së gruas. Sëmundja më rrallë haset te grat nën moshën 30 vjeçare. Instituti kombëtar i kancerit i SHBA-ve u propozon grave një kujdes të shtuar pas moshës 50-vjeçare.¹⁴

2.5.3 Gjina

Të qenit grua paraqet faktorin kryesor të rrezikut relativ për kancer të gjirit. Përderisa është edhe te burrat mund të ketë sëmundje, ajo është 100 herë më e shpeshtë tek grat se tek burrat.

6.1.6. Faktoret gjenetik. Çdo individ ka një kod të caktuar kimik, i cili përcakton se si do të duket ai dhe si funksionon organizmi i tij. Çdo njeri lind me gjenet BRCA1, BRCA2, TP53, përderisa nuk pësojnë ndryshime, nuk paraqesin problem shëndetsorë. Grat me këto ndryshime gjenetike kanë nga 60- 90% gjasa për të pasur gjatë jetës kancer të gjirit.

2.5.4 . Aktiviteti fizik

Studime të ndryshme kanë treguar se aktiviteti fizik e zvogëlon rrezikun për kancer të gjirit. Një studim ka treguar se vetëm 1 orë e 15 min deri 2 orë e 30 min në javë të ecjes së shpejtë ka ulur rrezikun për 18%. Rekomandohet që grat të kenë aktivitet fizik të paktën nga një, orë për 5 ditë në javë.

2.5.5 Alkooli

Përdorimi i alkoolit është qartazi i lidhur me rritjen e njëfarë mase të rrezikut nga fitimi i kancerit të gjirit. Në një meta-studim i një grupi studiuesish në vitin 2002 tregon se në shtetet e zhvilluara rreziku për kancer të gjirit nga konsumimi i alkoolit është rreth 4%.

¹⁴ (Asoglu O, 2005)

Alkooli e shton rrezikun në shfaqjen e kancerit të gjirit nese përdoret së bashku me terapinë hormonale estrogenike, ku rol vendimtar luan shtimi i nivelit të estrogenit.¹⁵

2.5.6 .Vetëkontrollimi i gjinjëve

